

Koha e saktë për ta nisur agjërimin

Shejh (Dr.) Heithem el-Haddad, islam21c.com

Ramazani, së bashku me fillimin e kohëve të namazeve të jacisë, të akshamit dhe të sabahut gjatë verës, i ka ngatërruar shumë muslimanë që jetojnë në Evropë dhe në Amerikën Veriore. Natyrisht, duke pasur parasysh rëndësinë e saktësisë së kohëve të namazit gjatë ramazanit, për komunitetin musliman është me rëndësi që ta konfirmojnë kohën e saktë për fillimin e agjërimin. Ky artikull diskuton fillimin e kohëve të agjërimin, që njihet si syfyr ose imsak, dhe rekomandon një kohë për namazin e jacisë dhe për teravitë (namazin e natës) gjatë muajit të bekuar.

Kur hyn koha e namazit të sabahut?

Sipas të gjithë dijetarëve, fillimi i kohës së namazit të sabahut është edhe fillimi i kohës së agjërimin. Ky konsensus (njëzëshmëri) mbështetet në ajetin:

“Hani e pini, derisa ta dalloni perin (dritën) e bardhë të agut nga peri (errësira e natës) i zi, pastaj plotësoni agjërimin deri në muzg.”¹

Pejgamberi ﷺ instrukttoi sahabët:

“Ezani i Bilallit nuk duhet të ju ndalojë të hani (syfyrin), sepse ai thërret ezanin natën. Prandaj, vazhdoni të hani e të pini, derisa ta dëgjoni ezanin e Abdullah ibn Umm Mektumit, se ai e thërret ezanin atëherë kur të fillojë të agojë.”²

Sabahu i përmendur në hadith, është sabahu i vërtetë (*el-Subh es-sadik*). Semrah ibn Xhundub përcolli se pejgamberi ﷺ tha:

“Drita vertikale (*el-Fexhr el-mustetiil* ose sabahu i rrejshëm) nuk duhet t’ju ndalojë të hani syfyrin. Ju mund të hani e të pini, derisa drita të duket se po zgjerohet (*el-Fexhr el-mustetiir* ose sabahu i vërtetë).”³

Si të vendosim për mënyrën e përcaktimit të kohës së saktë të sabahut?

Ndonëse shumica e dijetarëve pajtohen rreth shenjave shariatike (ligjore) të dhëna në tekstin hyjnor (Kuran dhe Sunet) lidhur me fillimin e sabahut, ata nuk pajtohen rreth mënyrës së interpretimit të këtyre shenjave si dukuri astronomike. Madje, edhe atëherë kur bien dakord rreth interpretimit, dijetarët dallojnë rreth mënyrës së trajtimit të agjërimin dhe pesë namazeve ditore, për shkak të parregullsisë në kohët e namazeve gjatë verës në Evropë dhe në Amerikën Veriore.

¹ El-Bekare, 187

² El-Buhari dhe Muslim

³ Sunen et-Tirmidhi

Shenjat shariatike dhe të parët me sy (*mushahadeh*)

Pasi t'i konfirmojmë shenjat shariatike për fillimin e agjërimit dhe të namazit të sabahut, si ta përcaktojmë sabahun e vërtetë? A bëhet kjo atëherë kur ne, qoftë individualisht, qoftë si komunitete të vetme, shohim me sy sabahun të ndodhë, apo atëherë kur thjesht të konfirmojmë ndodhjen e dukurisë astronomike (shenjave), edhe nëse nuk e shohim me sy? Dhe, nëse kjo përcaktohet me ndodhjen e dukurisë astronomike, si të vendosim se ajo ka ndodhur me siguri?

Mënyra e vetme për përcaktimin e fillimit të sabahut të vërtetë është të parët e vetë dukurisë (*mushahadeh*), domethënë, të parët global të kësaj dukurie (nga njerëzit), me çka ne mund të konfirmojmë praninë e dritës në horizont ose sabahun e vërtetë (*el-Subh el-sadik*). Të parët (e shenjave, dukurisë astronomike) prodhoi një formulë që përdoret si kriter në përcaktimin e fillimit të kohës së namazit, edhe nëse të parët (e shenjave) për një vend dhe një kohë nuk ndodh për shkak të faktorëve të shumtë, si: kushtet atmosferike, shikimi i dobët i syve, ose mosdija e interpretimit të vetë shenjave shariatike. Për shembull, nëse personi bën nijetin për të bërë iftar dhe s'ka mundësi ta shohë perëndimin e diellit për ndonjë arsye, megjithëkëtë ai mund të bëjë iftar, kur supozimi se dielli ka perënduar përputhet me perëndimin e zakonshëm (të rregullt) të tij. Ngjashëm me këtë, një person s'mund të vazhdojë të hajë syfyer me arsyetimin se vetë nuk e ka parë sabahun e vërtetë të ndodhë. Personi mund ta dijë kohën e sabahut të vërtetë ose duke e krahasuar me sabahun e ditës paraprake, ose nëpërmjet të parit e një personi tjetër, ose nëpërmjet kalkulimit. Në fakt, ai mund të bëjë një tabelë vjetore të kohës së namazeve (takvim) dhe ta përdorë në vitet vijuese; pra, ai s'ka nevojë t'i shohë me sy shenjat shariatike sa herë të hyjë koha e namazeve. Allahu ﷻ tha për kohët e faljes së namazit:

“Fal namazin nga mesdita deri në errësirën e natës (D.m.th. dreka, ikindia, akshami, jacia) dhe këndo Kuran në sabahun e hershëm (D.m.th. namazin e sabahut). Vërtet që këndimi i Kuranit në sabah dëshmohet (nga engjëjt e pranishëm).”⁴

Ajeti përcakton ndërlidhjen e kohëve të namazit vetëm me ndodhjen e dukurisë astronomike, jo edhe me të parit e dukurisë me sy. Kjo është në kontrast me hadithin e fillimit të ramazanit, i cili ndërlidhet me idenë e të parit fizik të hënës dhe nuk varet nga ndodhja e dukurisë astronomike (shenjës). Pejgamberi ﷺ tha:

“Agjëroni atëherë kur ta shihni hënën dhe ndërpriteni agjërimin atëherë kur ta shihni hënën.”⁵

Ka një konsensus të dijetarëve klasik muslimanë për atë se kalkulimet astronomike s'mund të përdoren në vend të të parit e hënës me sy (në ramazan). Këtu qëndron dallimi mes të parit të hënës, që është i nevojshëm për fillimin e

⁴ El-Israa, 78

⁵ Transmetuar nga Ebu Hurejre dhe Abdullah ibn Umer; el-Buhari dhe Muslim

muajit të ramazanit ose të haxhit, dhe të parit e muzgut që përdoret për përcaktimin e kohëve të namazit.

18 shkallë nën horizont për sabah dhe 17 ose 18 shkallë për jaci

Duke pasur parasysh këtë, mundim të nxjerrim përfundimin se nuk është me vend që të parët e një individ (mushahede) për kohët e namazit ta mohojë kriterin e pranuar, që del nga të parët (e kohës kur muzgu shfaqet dhe zhduket) e përhapur në nivel global dhe është vendosur në vende të ndryshme nëpër shekuj. Ky kriter është baza e vendimit të juristëve dhe astronomëve muslimanë për përcaktimin e sabahut atëherë kur dielli është 18 shkallë nën horizont për namazin e sabahut dhe 17 ose 18 shkallë për namazin e jaxisë. Duhet theksuar se zgjedhja e ofruar këtu për kohët e jaxisë (17 ose 18) është e parëndësishme, prandaj dhe s'ka nevojë të diskutohet.

Shumë dijetarë, përgjatë rrjedhës së historisë, në kohë të ndryshme dhe në regjione të ndryshme të botës, kanë parë (me sy) shenjat sheriatike që janë dhënë në tekstin hyjnor dhe kanë ardhur në përfundim se kjo përputhet me kriterin e të qenit e Diellit 18 shkallë nën horizont, që ata regjistruan atëherë. Fakti që aq shumë dijetarë nga vende të ndryshme dhe në periudha të ndryshme, gjatë një mijë viteve të fundit, kanë dalë me kalkulimin e njëjtë, më shumë i jep peshë formulës së 18 shkallëve sesa një opinion tjetër, të dalë nga një grupi të vogël njerëzish në një pjesë të botës gjatë të njëjtës periudhë kohore. Kjo s'është një çështje ku ke të bësh me dallim mes shkollave juridike (medhhebe), meqë shumica dërrmuese e dijetarëve të grupimeve fetare dhe të shkollave të mendimit pajtohen rreth formulës së 18 shkallëve. Së voni diskutova këtë çështje me Muftiun Teki Uthmani (në praninë e dijetarëve të tjerë), i cili tregoi se vetë ai, së bashku me 99% të dijetarëve të nën-kontinentit indian, konsiderojnë se formula prej 18 shkallësh është kalkulimi i saktë për kohët e namazit.

Cila është metoda e saktë e të parit (mushahede) për sabah?

Astronomët e hershëm muslimanë, si Muhamed ibn Xhabir ibn Sinan, i njohur si Albategnius (v.929 p.e.s.), konfirmoi se shenjat sheriatike të sabahut dhe të jaxisë janë të dukshme atëherë kur dielli është 18 shkallë nën horizont. Të tjerë dijetarë kanë pohuar të ketë një konsensus lidhur me këtë përfundim. Një ndër konferencat e fundit ku u diskutua kjo çështje tërësisht, qe ajo e organizuar nga Këshilli i Fikhut pranë Ligës Botërore të Muslimanëve (Muslim World League) në vitin 1986, ku dijetarë dhe astronomë nga mjedise e shkolla të ndryshme mendimi konfirmuan se sabahu shfaqet atëherë kur dielli është 18 shkallë nën horizont nga ana e lindjes. Ata po ashtu konfirmuan se koha e jaxisë hyn atëherë kur dielli është 17 shkallë nën horizont nga ana e perëndimit. Ky vendim u përsërit nga i njëjti këshill i fikut në vitin 2007, në përgjigje të një pyetjeje të

dërguar nga xhamia qendrore në Belgjikë. Tabela në vijim tregon institucione të ndryshme, që shërbejnë si pikë reference për kohët e sabahut dhe të jacisë në shumë vend të botës:

Institucioni	Këndi për sabah	Këndi për jaci
Universiteti i Shkencave Islame, Karaçi (Pakistan)	18°	18°
Shoqata Islamike e Amerikës Veriore	17.5° *	15°
Liga Botërore Muslimane	18°	17°
<i>Umm el-Kura</i> , Mekë	18° **	(90 minuta pas akshamit)
Autoritetit i Përgjithshëm Egjiptian për Vëzhgim	19.5°	-

* Shoqata Islamike e Amerikës Veriore e ka pasur për traditë kohën më të vonë të sabahut, për shkak të përdorimit të këndit prej 15 shkallësh. Por, në shtator të vitit 2011, ata rishikuan pozitën e tyre dhe u përcaktuan për 17.5 shkallë, që, pak a shumë, është në linjë me pjesën tjetër të botës.⁶

** Këtij institucioni i qe atribuar këndi prej 19 shkallësh, që është një kohë edhe më e hershme e sabahut ose pozita prej 90 minutash pas akshamit për jaci. Ndonëse në përdorimin e kalkulimit prej 18 shkallësh kohët e sabahut janë pothuajse të njëjta në Mekë, çka tregon se pozita e 90 minutave është e njëjtë me atë të 18 shkallëve dhe, për shkak të pozitës së saj ekuatoriale, kjo nuk ndryshon shumë përgjatë vitit.

Siç mund të shohësh në tabelë, shumica e këtyre institucioneve konsiderojnë se 18 shkallë është minimumi për përcaktimin e kohës së sabahut.

Këshillë për xhematin dhe për këshillin udhëheqës të xhamive

Askush nuk mund të thotë se personi duhet thjesht të ndjekë provat tekstuale, meqë këtu çështja ka të bëjë me interpretim. Është e vërtetë se disa individë mund të mos binden për një konkludim të caktuar, megjithatë do të ishte shkatërrimtare për fenë e Allahut që kjo t'i lihej zgjedhjes individuale. Muslimani është i obliguar të lërë shumë konkluzione personale dhe të ndjekë ato për të cilat ka konsensus të dijetarëve, gjë që pa dyshim se është e bazuar në Kuran dhe në Sunet. Sigurisht, një individ mund të adoptojë një konkluzion, por nuk bën që t'i instruktojë të tjerët ta lënë opinionin e rrymës kryesore islame për konkluzionin e tij personal. U bëj apel këshillave udhëheqës të xhamive që në

⁶ http://www.icoproject.org/ISNA-Adopts-New-Angles-for-Fajer-and-Isha_ad-id!81.ks

asnjë çështje të mos marrin një vendim që dallon nga vendimi i adoptuar nga shumica dërrmuese e muslimanëve. Bazë për këtë është autoriteti që sheriati i ka dhënë konsensusit të dijetarëve muslimanë. Pejgamberi ﷺ tha se ky umet nuk do të pajtohet rreth një gabimi, kështu që opinioni i një pakice s'mund të qëndrojë karshi shumicës dërrmuese, e cila, në fakt, është e barasvlershme me konsensus.

Përse individët s'bën t'i ndjekin xhamitë e tyre lokale (në përcaktimin e kohës së sabahut)?

Aktet individuale të adhurimit janë çështje për të cilat individi do të merret në përgjegjësi. Aktet që nuk ndërlidhen me muslimanët e tjerë, nuk përfshihen në aktet e adhurimit nga të cilat personi mund të heqë dorë për hir të unitetit ose thjesht për të ndjekur verbazi të tjerët. Ndonëse njerëzit duhet të falin namazin me xhemat në xhamitë e tyre lokale, fillimi i agjërimit nuk ndërlidhet me kohën e xhamive lokale. Prandaj, personi duhet të përpiqet ta identifikojë pozitën e saktë, që do të lirojë nga çfarëdo përgjegjësie në Ditën e Gjykimit.

Si po mbetet çështja e përhapjes së dritës në horizont (*Tebejjun*)?

Shumica dërrmuese e dijetarëve klasik kanë adoptuar kalkulimin e 18 shkallëve për sabah dhe 17 ose 18 për jaci. Për këtë arsye, nuk ka mospajtim të njëmendte që mund të përdoret si justifikim për *ixhtihad* ose për të adoptuar opsionin më të lehtë. Për më shumë, përhapja e dritës në horizont ndodh edhe atëherë kur ne nuk jemi krejtësisht të sigurt se drita e sabahut është e qartazi e dukshme. Ata që adoptojnë formulën e 18 shkallëve, janë të sigurt për shfaqjen e dritës së sabahut, kështu që *tebejjun* arrihet pa adoptuar një shkallë më të ulët.

Si po mbetet puna e jacistë? Çfarë mund të bëjmë gjatë periudhës verore, kur muzgu nuk largohet?

Sipas kalkulimit të 18 shkallëve, ka një periudhë gjatë verës (për vendet mbi një gjerësi gjeografike të caktuar), ku muzgu i akshamit nuk zhduket – një dukuri që njihet si muzgu i qëndrueshëm (ku shenjat treguese sheriatike për hyrjen e kohës së jacistë nuk bëhen të dukshme). Koha për jaci është tepër vonë, ndërsa koha për sabah është tepër herët; menjëherë para dhe pas kësaj periudhe. Për shembull, kjo periudhë në Londër fillon më 26 maj, ku muzgu i qëndrueshëm mbetet deri afërsisht në ora 12:35 dhe koha e sabahut hyn rreth orës 1:15 (AM). Kjo periudhë përfundon rreth datës 19 korrik, kur sabahu është në ora 1:18 (AM). Për këtë periudhë të mungesë së shenjave sheriatike, dijetarët kanë sugjeruar dy metoda kryesore:

- 1) Llogaritjen, ose

2) Adoptimin e kohës së ditës së fundit në të cilën shenjat shariatike kanë qenë të dukshme

Llogaritja krijon një boshllëk të madh mes ditës së fundit, në të cilën shenja është e dukshme, dhe ditës së radhës. Po ashtu, kjo krijon një boshllëk mes ditës kur shenjat nuk shihen dhe ditës së radhës. Metoda e vetme e qëndrueshme është adoptimi i kohës së ditës së fundit në të cilën shenja që e dukshme, derisa të bëhet prapë e dukshme. Kjo është një metodë sistematike, në të cilën nuk shihen boshllëqe të mëdha mes ditëve të ndryshme.

Ka edhe një nivel lakueshmërie për fillimin e kohëve të jaciesë, kur koha e saj është mjaft vonë. Dijetarët kanë metoda të ndryshme për situatën kur jacia shtyhet shumë vonë, meqë kjo përfshin një vështirësi të konsiderueshme në faljen e këtij namazi në kohë kaq të vonë. Dy metodat kryesore janë: a) kombinimi i namazit të akshamit dhe të jaciesë; b) llogaritja e kohës së jaciesë. Këshilli i fikut pranë Ligës Botërore të Muslimanëve nxori një vendim gjatë asamblesë së 19-të të tyre në Mekën e Ndërshtetë, të mbajtur më 08.11.2007, lidhur me kohët e namazit për vendet që ndodhen mes gjerësive gjeografike prej 48 dhe 66 shkallësh në Veri dhe në Jug:

“Për të sqaruar këtë vendim më tej, me qëllim që t’i përgjigjemi rastit problematik që i është parashtruar Këshillit, vendimin e mëhershëm që instruktën për përdorimin e referimit (ndaj regjioneve të tjera) për vendet me gjerësi gjeografike mes 48 dhe 66 shkallëve Veri dhe Jug Këshilli e konsideron të jetë i veçantë për rastin kur shenjat astronomike për atë kohë nuk ekzistojnë. Për sa i përket rastit kur shenjat e kohëve të namazit ndodhin, por zhdukja e muzgut që tregon fillimin e jaciesë është tepër vonë, Këshilli konsideron se është obligim të falet namazi i jaciesë në kohën e saj të përcaktuar. Kushdo që has në vështirësi në pritjen për të falur namazin në kohën e tij, siç mund të jenë studentët dhe punonjësit e ditës, mund t’i kombinojë namazet në përputhje me provat tekstuale, që kanë të bëjnë me heqjen e vështirësive për umetin. Një shembull i kësaj është transmetimi nga Ibn Abbas dhe nga të tjerë:

“I Dërguari i Allahut kombinoi namazin e drekës dhe të ikindisë, të akshamit dhe të jaciesë, pa pasur ndonjë frikë ose të reshura (shi).”

Ibn Abbas që pyetur për këtë dhe ai u përgjigj: “Ai ﷺ nuk deshi t’ua vështirësonte umetin.” Kushti për këtë është që kombinimi të mos bëhet shprehi për të gjithë njerëzit e atij vendi gjatë gjithë kohës sa zgjat kjo gjendje, sepse kjo do ta kthente lehtësimin e kombinimit në një veprim të obligueshëm e të përhershëm, të synuar që nga fillimi. Këshilli, po ashtu, konsideron të jetë me vend adoptimi i metodës së përafresë (me kohën e fundit kur janë dukur shenjat) dhe shpërndarjes (sistemimit) së kohëve të namazit në një situatë të këtillë.”

Falja e namazit të jaciesë sipas 18 shkallëve është më së miri të adoptohet përderisa koha e jaciesë të bjerë para mesnate (në mes akshamit dhe sabahut). Mirëpo, meqë shiati lejon lehtësime për disa vështirësi, falja e namazit të jaciesë para kohës së saj mund të bëhet duke kombinuar namazet (aksham me jaci), gjë

që disa dijetarë e kanë lejuar për raste të vështira dhe të domosdoshmërisë. Në shariat është e njohur që rigoroziteti i zbatuar në rastin e namazit të sabahut, të drekës dhe të akshamit nuk është si ai i jacisë dhe ikindisë, meqë kohët e këtyre, në raste të domosdoshme, bashkohen me aksham dhe me drekë përkatësisht. Ne duhet ta falim namazin e jacisë para mesnate dhe shumë më përpara se sabahun, me qëllim që t'i shmangemi kombinimit të jacisë me sabahun. Nëse zgjedhja më e mirë s'mund të zbatohet, sugjeroj që jacia të falet në kohën më të vonë që njerëzit mund ta falin pa vështirësi, siç është ora 11:00 (PM). Kjo kohë duhet të respektohet, derisa të kthehet koha e këtij namazi në një pjesë më të hershme të ditës. Për sa i përket ramazanit, teravive ose *kijamu-lejlit* (përfshirë dhe vitrin), këtë duhet falur pas namazit të jacisë dhe të përfundohet në kohën që u lejon njerëzve të hanë syfyryn.

Me gjithë këtë që shkrova dhe nuk u pajtova me disa, i nxisë të gjithë që të zbatojnë etiketën islame të mospajtimit. Ne nuk bën të lejojmë që dallimet e këtilla të na përçajnë ose të mbjellin urrejtje në zemrat tona. Allahu na mbajt të bashkuar, i mbajt të pastra zemrat e tona, dhe na i faltë gabimet!

Për kohën e namazeve për cilindo vend në botë vizito linkun në vijim:
<https://www.islam21c.com/prayertimescalculator/>

Linku për Telegram: <https://t.me/PrayerTimesCalculatorBot>